



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit lidhur me pretendimet për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, Trupi Gjykses më 16 mars urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Kadri Veselit pasi konstatoi se ende ekzistonte rreziku që z. Veseli të pengonte ecurinë e procesit apo të kryente vepra penale të tjera.

Trupi Gjykses rikonfirmoi konstatimin e vet se emrat dhe të dhënat personale të disa dëshmitarëve tejet të cenueshëm ishin nxjerrë për Mbrojtjen dhe, pavarësisht fazës në të cilën ndodhet procesi gjyqësor, lirimi i një të akuzuari që ka informacion të ndjeshëm nuk do t'i kontribuonte mbrojtjes efektive të dëshmitarëve. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses rikujtoi konstatimin e vet se rreziku i ndërhyrjes, që paraburgimi synon ta parandalojë, përfshin edhe përpjekjet për t'u hakmarrë ndaj dëshmitarëve, apo për t'i nxitur dëshmitarët që kanë dhënë dëshmi ta tërheqin atë.

Ndonëse vlerësoi se aktualisht mundësia për ndërhyrje është e kufizuar për shkak se kohët e fundit Prokuroria ka mbyllur paraqitjen e provave të saj edhe në procesin gjyqësor paralel, Trupi Gjykses rikujtoi atmosferën e vazhdueshme të frikësimit dhe ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve në proceset penale kundër ish-anëtarëve të UÇK-së, që nuk mund të mënjanohet vetëm me masa mbrojtëse.

Trupi Gjykses rikonfirmoi gjithashtu konstatimin se vetëm nëpërmjet kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të DHS-së, komunikimet e z. Veseli mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rreziqet e pengimit të procesit.





Trupi Gjykses pranoi se z. Veseli ka një kohë të konsiderueshme që është në paraburgim dhe ishte i vetëdijshëm lidhur me nevojën për të garantuar që procesi të vijojë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Më 13 mars, Gjykatësi i Vetëm caktoi disa afate në çështjen gjyqësore kundër Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit lidhur me pretendime për ndikim ndaj dëshmitarëve.

Në qoftë se ekipet e Mbrojtjes synojnë të dorëzojnë kërkesë për rrëzimin e një ose të gjitha akuzave në këtë çështje gjyqësore, Gjykatësi i Vetëm i urdhëroi që ta bëjnë këtë deri më 23 mars. Prokuroria duhet të dorëzojë përgjigje ndaj këtij mocioni deri më 25 mars. Gjykatësi i Vetëm synon të lëshojë vendim mbi këto mocione, në qoftë se do të ketë, deri më 27 mars.

Në varësi të vendimit mbi mocionin, dhe në rast se ekipet e Mbrojtjes vendosin të paraqesin prova, ata urdhërohen të dorëzojnë informacionin lidhur me paraqitjen e provave, përfshirë listat e dëshmitarëve të tyre, informacion mbi dëshmitë përkatëse, prova të tjera që synojnë të paraqesin, si dhe një parashikim për kohëzgjatjen e paraqitjes së provave të tyre, deri më 27 mars. Dhënia e informacionit shtesë dhe nxjerrja e materialeve mund të bëhet deri më 1 prill. Mocionet e mundshme të Mbrojtjes për pranimin e provave materiale duhet të dorëzohen deri më 2 prill 2026.

Konferenca përgatitore për Mbrojtjen do të mbahet në javën e 30 marsit 2026.

Deklaratat hyrëse të Mbrojtjes, nëse do të ketë, do të mbahen më 7 prill, pas të cilave do të fillojnë dëshmitë e të gjithë dëshmitarëve të Mbrojtjes, nga 7 deri më 24 prill. Hashim Thaçi, Fadil Fazliu dhe Hajredin Kuçi ende nuk i kanë mbajtur deklaratat e tyre hyrëse dhe mund të vendosin ta bëjnë këtë në fillim të paraqitjes së provave prej Mbrojtjes.





Më 12 mars, Gjykatësi i Vetëm rrëzoi kërkesën e Mbrojtjes së Smakajt për të redaktuar disa pjesë të transkripteve dhe përkthimeve të dy audioincizimeve të vizitave të z. Smakaj te z. Thaçi. Pjesët që Mbrojtja e Smakajt kërkoi të redaktoheshin ishin ato ku ishte shtuar identiteti i folësit, toni i zërit, apo përshkrimi i zhurmave joverbale, si lëvizjet apo veprimet.

Gjykatësi i Vetëm vlerësoi se tashmë vendimi për pranimin në prova të transkripteve dhe përkthimeve përkatëse të dy audioincizimeve në tërësinë e tyre tashmë ishte marrë. Sidoqoftë, Gjykatësi i Vetëm rikujtoi se ishte pranuar që atribuimi prej Prokurorisë i identiteteve të folësve dhe përshkrimet e tonit të folësve apo të zhurmave joverbale që dëgjohen në audioincizim, nuk kanë vlerë provuese dhe këtyre atribuimeve apo përshkrimeve nuk do t'u jepet peshë.

Për rrjedhojë, Gjykatësi i Vetëm konstatoi se Mbrojtja e Smakajt nuk ka demonstruar gabim arsyetimi në vendimin e mëparshëm dhe as nuk ka demonstruar se rishqyrtimi i tij është i nevojshëm për të shmangur padrejtësinë.

Më 16 janar, Gjykatësi i Vetëm miratoi pjesërisht kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për të hequr ndalimin e vizitave jo të privileguara të 11 personave te z. Thaçi në objektin e paraburgimit.

Gjykatësi i Vetëm hoqi ndalimin e vizitave në lidhje me një person dhe urdhëroi vijimin e ndalimit të vizitave te z. Thaçi për 10 personat e tjerë.

Gjykatësi i Vetëm rikujtoi se këto masa u morën mbi bazën e konstatimit gjyqësor për ekzistencën e dyshimit të bazuar mirë se 11 personat pretendohej se kishin kryer shkelje që rrezikuan sigurinë e dëshmitarëve në një proces penal. Gjykatësi i Vetëm vlerësoi se kufizimet nuk prekin vizitat familjare dhe numri i tyre është i kufizuar, pasi kanë të bëjnë vetëm me 10 persona. Për rrjedhojë, Gjykatësi i Vetëm konstatoi se kufizimet nuk cenojnë të drejtën e z. Thaçi për respektim të jetës familjare.





Gjykatësi i Vetëm është i vetëdijshëm se rreziku që informacioni i ndjeshëm lidhur me dëshmitarët të bëhet publik ekziston edhe pas dhënies së dëshmisë prej dëshmitarëve, pasi shumë prej tyre kanë masa mbrojtëse dhe identitetet e tyre nuk duhet të bëhen asnjëherë të ditura për publikun.

Për rrjedhojë, Gjykatësi i Vetëm konstatoi se masat e mbetura ishin të domosdoshme dhe proporcionale. Sidoqoftë, ai konfirmoi se ky vendim do të jetë në fuqi për aq kohë sa është i domosdoshëm dhe proporcional dhe njoftoi se rishikimi vijues i kushteve të paraburgimit të z. Thaçi do të bëhet pas mbylljes së paraqitjes së provave në këtë çështje gjyqësore, apo me kërkesë për rishikim nga Mbrojtja e Thaçit në ndërkohë.

Vendimi u bë publik më 16 mars dhe mund të gjendet në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara.

Së fundi, dëshiroj t'ju informoj se javën e ardhshme, më 26 mars, informimi javor i Dhomave të Specializuara do të mbahet në orën 9:30 të mëngjesit. Më pas, transkripti dhe incizimi do të jenë të disponueshëm në faqen e internetit.

